

FLETËNOTIM SCORECARDS

VII - XII, 2008



**PRIZREN
SUHAREKË
MALISHEVË
RAHOVEC
DRAGASH**

SI TA LEXOJMË FLETËNOTIMIN?

PËRMBAJTJA

1. Shpjegime mbi fletënotimin / Si ta lexojmë fletënotimin?	3
a. Komunat	3
b. Kategoritë	3
c. Periudha Kohore	3
d. Legjenda	3
2. Fletënotimet dhe analiza	
a. Prizren	4
b. Suharekë	10
c. Malishevë	16
d. Rahovec	22
e. Dragash	28
3. Analiza	34

STAFI

Ismet KRYEZIU - Drejtor Ekzekutiv
Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës dhe financave
Leonora CIKAJ - Asistente për administratë dhe financa

Programi - Qeverisja Lokale

Bleranda ZOGAJ - Menaxhere e programit
Ramadan KLISURICA - Monitorues

Programi - Qeverisja Qendrore

Valmir ISMAILI - Menaxher programi
Driton SELMANAJ - Asistent i programit
Fitore ZENELI - Asistente e programit
Isuf ZEJNA - Monitorues
Kaltrina ADEMI - Monitorues
Rezarta AHMETI - Monitorues

Programi - Transparenca dhe Antikorrupsioni

Merita MUSTAFA - Menaxhere e programit
Admir ISTREFI - Asistent i programit
Besnik RAMADANAJ - Zyrtar për marrdhënie me publikun
Sahit BIBAJ - Avokat / Këshilltar juridik
Natyra KASUMAJ - Vullnetare
Visar RAMAJ - Vullnetar

Arsim GJINOVI - prepress

NOTIMI

Vlerësimet janë të bazuara në vëzhgimin e drejtpërdrejtë dhe objektiv të punimeve të Kuvendeve të Komunave. Monitoruesit e Institutit Demokratik të Kosovës kanë përcjellë të gjitha seancat e pesë Kuvendeve Komunale gjatë periudhës Korrik - Dhjetor 2008. Për më tepër, monitoruesit e KDI-së kanë realizuar një numër të konsiderueshëm të takimeve individuale me shumë anëtarë, kanë organizuar seri të tryezave dhe debateve në çështje të ndryshme. Anëtarët komunalë dhe subjektet politike janë notuar veç e veç në secilën nga pesë kategoritë e poshtëshënuara si dhe mbi performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në përqindje (%).

KOMUNAT

Ky fletënotim përmban analiza dhe statistika mbi punën e anëtarëve që përfaqësojnë subjektet politike në Kuvendet e Komunave në vijim: Prizren, Suharekë, Malishevë, Rahovec dhe Dragash.

KATEGORITË

KDI në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e anëtarëve komunalë dhe subjekteve politike në 2 kategori të paraqitura në vijim të cilat janë të ndara në nënkategori:

I. Performanca dhe roli i anëtarit në legjislativ

1. Pjesëmarrja e anëtarëve dhe subjekteve politike në diskutimet gjatë seancave të Kuvendit të Komunës
2. Inicimi i çështjeve me interes të përgjithshëm për qytetarët
3. Inicimi i rregullore të reja komunale
4. Propozimi i amendamenteve në legjislacion
5. Propozim për rend dite

II. Analiza

1. Respektimi i ligjit për vetëqeverisje lokale
2. Efikasiteti dhe transparenca e Kuvendeve të Komunave
3. Kë e përfaqësojnë anëtarët e Kuvendeve të Komunave

PERIUDHA KOHORE

Notimi i anëtarëve komunalë dhe subjekteve politike është bërë për periudhën 6 mujore, Korrik - Dhjetor 2008.

LEGJENDA

- * - Kryetari i Kuvendit të Komunës
- ** - Shefat e Grupeve Parlamentare
- *** - Anëtarët e rinj të Kuvendit

REZULTATET E NOTIMEVE PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS PRIZREN PËR PERIUHDHËN KORRIK - DHJETOR 2008

KUVENDI I KOMUNËS PRIZREN			Pjesëmarrja në seanca	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seanceve	Propozim për rend dite	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislacionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm
Nr	Anëtarët e Kuvendit të Komunës	Subjekti politik	%	%	%	%	%	%	%	%
1	Afrim Avdaj	PDK	100%	3.2%	12.5%	1.5%	0	5%	8.5%	4.5%
2	Bedri Hoxha	PDK	71.4%	0.3%	0%	0.2%	0	0%	0%	0.1%
3	Besnik Krasniqi	PDK	100%	4.3%	0%	3.8%	0	2%	11.3%	5.5%
4	Ethem Rugova	PDK	85.7%	1.3%	0%	0.6%	0	0%	0%	0.5%
5	Hajrim Qengaj**	PDK	100%	4.6%	0%	4.8%	0	2%	0%	2.9%
6	Mybexhel Zhuri	PDK	100%	1.1%	0%	1.9%	0	2%	2.8%	2.1%
7	Natyre Mullafetahu	PDK	100%	0.5%	0%	1.0%	0	0%	1.4%	0.7%
8	Nehale Shendeti	PDK	100%	0%	0%	0%	0	0%	0%	0%
9	Nijazi Kryeziu*	PDK	100%	11.0%	0%	1.5%	0	0%	0%	3.1%
10	Sylbije Osmanaaj	PDK	100%	0.3%	0%	0.2%	0	0%	0%	0.1%
11	Shukri Quni	PDK	100%	0.3%	0%	0.2%	0	0%	0%	0.1%
12	Agim Muçaj	LDK	71.4%	3.5%	0%	5.6%	0	7%	2.8%	4.8%
13	Hasan Hoti	LDK	57.1%	1.3%	0%	6.1%	0	0%	2.8%	2.6%
14	Haziz Hodaj**	LDK	71.4%	8.6%	37.5%	9.4%	0	5%	2.8%	6.4%
15	Kimete Hoxha	LDK	71.4%	0.3%	0%	0.2%	0	0%	0%	0.1%
16	Masar Shporta	LDK	71.4%	1.3%	0%	2.7%	0	7%	4.2%	3.9%
17	Mybera Mustafa	LDK	71.4%	1.6%	0%	1.3%	0	5%	2.8%	2.7%
18	Qamil Buzhala	LDK	71.4%	0.3%	0%	0.2%	0	10%	0%	2.6%
19	Ridvan Hoxha	LDK	57.1%	1.9%	0%	6.3%	0	12%	4.2%	6.2%
20	Semahate Mashkulli	LDK	57.1%	1.3%	0%	1.9%	0	5%	0%	2.0%
21	Xhevat Xhoxhaj	LDK	57.1%	1.1%	0%	1.5%	0	0%	2.8%	1.4%
22	Adelina Beqiri	AKR	100%	1.1%	12.5%	1.5%	0	0%	7.0%	2.4%
23	Agim Susuri	AKR	85.7%	0%	0%	0%	0	0%	0%	0%
24	Faik Miftari **	AKR	100%	4.0%	0%	3.8%	0	5%	9.9%	5.6%
25	Ajshë Shala	AAK	71.4%	1.1%	0%	1.9%	0	0%	1.4%	1.1%
26	Fatmir Kastrati	AAK	57.1%	1.1%	0%	2.9%	0	2%	0%	1.6%
27	Masar Shala **	AAK	71.4%	7.5%	12.5%	5.4%	0	5%	1.4%	4.8%
28	Ercan Špat	KDTP	85.7%	2.1%	0%	0.6%	0	0%	1.4%	1.0%
29	Enis Subi	KDTP	100%	1.6%	0%	0.8%	0	2%	0%	1.2%
30	Müveddet Bako	KDTP	85.7%	1.9%	0%	1.9%	0	0%	0%	0.9%
31	Çemalij Kurtiši	VAKAT	100%	4.3%	0%	3.4%	0	10%	0%	4.4%
32	Memnuna Ajdini	VAKAT	100%	1.3%	0%	2.1%	0	2%	7.0%	3.2%
33	Dželilij Elezi	VAKAT	100%	0.5%	0%	0.4%	0	0%	1.4%	0.6%
34	Haki Gajraku	LDD	85.7%	5.1%	0%	5.9%	0	5%	8.5%	6.1%
35	Sebahate Ahmetaj	LDD	57.1%	0.3%	0%	0.2%	0	0%	0%	0.1%
36	Besnik Krajku	ORA	85.7%	3.2%	25.0%	2.3%	0	0%	4.2%	2.4%
37	Vjosa Curri	ORA	100%	1.1%	0%	2.3%	0	0%	2.8%	1.5%
38	Abaz Ademi	SDA	85.7%	4.3%	0%	3.8%	0	2%	4.2%	3.7%
39	Hasan Hasani		100%	7.8%	0%	6.7%	0	2%	2.8%	4.9%
40	Trendelina Spahiu		71.4%	0.3%	0%	1.0%	0	0%	1.4%	0.7%
41	Ajini Sinani		85.7%	3.5%	0%	2.1%	0	0%	0%	1.4%

Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca			Pjesëmarrja në seanca	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seanceve	Propozim për rend dite	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislacionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm
Nr	Subjektet politike	Numri i anëtarëve	%	%	%	%	%	%	%	%
1	PDK	11	96.1%	26.8%	12.5%	15.7%	0%	12.2%	23.9%	18.2%
2	LDK	10	65.7%	21.2%	37.5%	35.2%	0%	51%	22.5%	33.5%
3	AKR	3	95.2%	5.1%	12.5%	5.4%	0%	5%	16.9%	8.9%
4	AAK	3	66.7%	9.7%	12.5%	10.2%	0%	7%	2.8%	8.5%
5	KDTP	3	90.5%	5.6%	0%	3.3%	0%	2%	1.4%	2.5%
6	VAKAT	3	100%	6.2%	0%	5.9%	0%	12%	8.5%	6.6%
7	LDD	2	71.4%	5.4%	0%	6.1%	0%	5%	8.5%	5.0%
8	ORA	2	92.9%	4.3%	25.0%	4.6%	0%	0%	7.0%	8.2%
9	SDA	1	85.7%	4.3%	0%	3.8%	0%	2%	4.2%	3.0%
10	Hasan Hasani	1	100%	7.8%	0%	6.7%	0%	2%	2.8%	3.9%
11	Trendelina Spahiu	1	71.4%	0.3%	0%	1.0%	0%	0%	1.4%	0.5%
12	Ajini Sinani	1	85.7%	3.5%	0%	2.1%	0%	0%	0%	1.1%

LEGJENDA
 * - Kryetari i Kuvendit të Komunës
 ** - Shefat e Grupeve Parlamentare
 *** - Anëtarët e ri të Kuvendit

Rr - Rregulloret e propozuara

KUVENDI I KOMUNËS - PRIZREN

NOTIMI I PËRGGJITHSHËM

Kuvendi i Komunës së Prizrenit numëron gjithsej 41 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 9 subjekte politike (PDK, LDK, AKR, AAK, KDTP, VAKAT, ORA, LDD, SDA dhe tre të pavarur).

Anëtarët e Kuvendit të Komunës që kanë shënuar rezultate më të kënaqshme në të gjitha kategoritë janë:

Haziz Hodaj	LDK	6.4%
Ridvan Hoxha	LDK	6.2%
Haki Gajraku	LDD	6.1%

Anëtarët që kanë treguar rezultatet më të dobëta (0.5% – 0.1%) në të gjitha kategoritë janë:

Ethem Rugova	PDK	0.5 %
Shukri Quni	PDK	0.1 %
Bedri Hoxha	PDK	0.1 %
Sylbije Osmanaj	PDK	0.1 %
Kimete Hoxha	LDK	0.1 %
Sebahate Ahmetaj	LDD	0.1 %

Anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultatet në të gjitha kategoritë janë:

Nehale Shëndeti	PDK	0.0 %
Agim Susuri	AKR	0.0 %

(Sipas këtyre të dhënave anëtarët që kanë treguar performanc më të lartë janë: Haziz Hodaj (LDK) me 6.4 % , Ridvan Hoxha (LDK) me 6.2% dhe Haki Gajraku (LDD) me 6.1%. Ndërkaq të vlerësuar me 0% janë 2 anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prizrenit të cilët asnjëherë nuk kanë diskutuar në foltoren e Kuvendit gjatë periudhës Korrik - Dhjetor 2008.)

Përplasjet që janë shfaqur gjatë vitit 2008 tek anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit në raport me subjektet politike të cilat i përfaqësojnë janë thelluar edhe më tej, dhe si rezultat i saj Hasan Hasani, Trëndelina Spahiu dhe Ajni Sinani tashmë janë deklaruar se veprojnë si anëtarë të pavarur të Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2008, në gjashtëmujorin e dytë të këtij viti anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit kanë treguar angazhim më të shtuar në drejtim të përfaqësimit të interesit të qytetarëve në këtë institucion duke avancuar më tej punën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit por pa lënë anash edhe interesat e tyre personale dhe partiake. Vërehet edhe rënie prej 60% të numrit të anëtarëve të notuar me 0% gjatë kësaj periudhe në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2008.

MUNGESAT NË SEANCA


Me gjithë mospjesëmarrjen e anëtarëve nga radhët e LDK-së dhe AAK-së në dy mbledhjet e fundit dhe lëshimit të mbledhjes së fundit nga anëtarët e LDD-së, gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 nuk është evidentuar asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës së Prizrenit me pjesëmarrje më të ulët se në 50% të seancave.

TRENDI I DISKUTIMEVE


Niveli i pjesëmarrjes në diskutime i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Prizren gjatë shtatë mbledhjeve të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 ka treguar trend mesatar pos dy mbledhjeve të fundit kur anëtarët nga radhët e dy subjekteve politike opozitare të Kuvendit të Komunës së Prizrenit nuk kanë marrë pjesë në punimet e Kuvendit. Pjesëmarrje më e lartë e anëtarëve në diskutime është realizuar në seancën e 15 Tetorit me 63 % ku mes tjerash në rend dite ka qenë shqyrtimi i Draft Statutit të Komunës së Prizrenit dhe shqyrtimi i propozim-rregulloreve lidhur me sjelljen dhe disiplinën e nxënësve të shkollave fillore, të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të komunës së Prizrenit.

Ndërkaq niveli më i ulët i pjesëmarrjes së anëtarëve në diskutime me vetëm 7 % është realizuar në seancën e datës 12 Dhjetor ku në rend dite ka qenë prezantimi i projektit HC “Zhuri”. Në shtatë seancat e mbajtura gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 në Kuvendin e Komunës së Prizrenit, anëtarët nga radhët e PDK-së kanë shënuar nivelin më të lartë të pjesëmarrjes në diskutime me 26.8 % të diskutimeve të përgjithshme të përcjellë nga anëtarët e LDK-së me 21.2 % nga diskutimet e përgjithshme.

Trendi i diskutimeve korrik-dhjetor 2008



Niveli i diskutimeve sipas subjektit politik



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

Në Kuvendin e Komunës së Prizrenit nga 41 anëtarë të këtij kuvendit komunal 2 prej tyre asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në diskutime gjatë seancave dhe njëkohësisht nuk kanë ngritur ndonjë çështje në interes të qytetarëve gjatë kësaj periudhe.

Ndërkohë Haziz Hodaj ka treguar pjesëmarrje më të lartë në diskutim në Kuvendin e Komunës së Prizrenit me 8.6 % të diskutimeve të përgjithshme.

PROPOZIME PËR REND DITE

Në shtatë seancat e mbajtura në Kuvendin e Komunës së Prizrenit gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 janë propozuar tetë pika për rend dite. 3 propozime për pika të rendit të ditës ka parashtruar Haziz Hodaj (LDK), 2 propozime ka parashtruar Besnik Krajku (ORA) ndërkaq nga një propozim për pikë të rendit të ditës në Kuvendin e Komunës së Prizrenit kanë propozuar Adelina Beqiri (AKR), Masar Shala (AAK) dhe Afrim Avdaj (PDK).

KUVENDI I KOMUNËS - PRIZREN

INICIMI I ÇËSHTJEVE


Në shtatë seancat e mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit janë ngritur gjithsej 522 çështje që në një mënyrë prekin interesin e qytetarëve të Komunës së Prizrenit.

Çështjet që lidhen me arsimin në Komunën e Prizrenit përbëjnë pjesën kryesore të shqetësimeve të plasuar në Kuvend në shtatë seancat e mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 në Kuvendit e Komunës së Prizrenit me 43 %. Ndërkaq ende mbetet i lartë angazhimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit për çështjet që lidhen me aspekte procedurale të funksionimit të organeve të Komunës së Prizrenit prej të cilave 34 % e çështjeve të përgjithshme të ngritura janë të aspektit procedural.

Anëtarët nga radhët e LDK-së në Kuvendin e Komunës së Prizrenit prijnë për nga numri i inicimit të çështjeve me 35.2 % të përcjellë nga anëtarët e PDK-së me 15.7 % dhe AAK-së me 10.2 %.


Anëtari më aktiv gjatë këtyre shtatë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 në Kuvendin e Komunës së Prizrenit kanë qenë Haziz Hodaj (LDK) me 9.4 % të çështjeve të natyrave të përgjithshme. Krahas kësaj dy anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prizrenit nuk kanë ngritur asnjë çështje gjatë kësaj periudhe.

Duhet theksuar se numri më i madh i çështjeve janë ngritur në seancën e jashtëzakonshme të datës 17 Tetor 2008 ku në rend dite ka qenë diskutimi mbi Gjendjen aktuale të Arsimit në Komunën e Prizrenit.



Çështjet e inicuar

Inicimi i çështjeve sipas subjektit politik



RREGULLORET E INICUARA

Gjatë shtatë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit kanë miratuar Rregulloren për tatimin në pronë të patundshme në Komunën e Prizrenit, Rregulloren për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta dhe Rregulloren për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve të shkollave të mesme të larta.


PROPOZIMI I AMANDAMENTEVE

Gjatë shtatë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 në Kuvendin e Komunës së Prizrenit janë propozuar gjithsej 41 amendamente. Nga këto, LDK ka bërë 51.2 % amendamente të legjislacionit.

Numri më i madh i propozimeve për amendamentim është bërë në seancën e datës 15 tetor 2008 kur në rend dite ka qenë shqyrtimi i Draft Statutit të Komunës së Prizrenit dhe shqyrtimi i rregulloreve për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve të shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta.

Anëtarë më aktiv në propozim të amendamenteve gjatë shtatë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 janë Ridvan Hoxha (LDK) me 12.2 % Qamil Buzhala (LDK) me 9.8 % dhe Čemailj Kurtiši (VAKAT) me 9.8% të propozimeve për amendamentim.

Propozimi i amendamenteve sipas subjekteve




Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

KUVENDI I KOMUNËS - PRIZREN


PYETJET E ANËTARËVE

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 kanë bërë gjithsej 71 pyetje ndaj ekzekutivit të kësaj komune por gjithsej 38 % e këtyre pyetjeve kanë qenë të lidhura me aspekte procedurale të punës së organeve të Komunës së Prizren.

Llojet e pyetjeve



Pyetjet sipas subjekteve



Nga 41 anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, 17 prej tyre ose shprehur në përqindje 39 % e tyre nuk kanë parashtruar asnjë pyetje.

Ndërkohë që gjatë shtatë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 më aktiv në parashtrimin e pyetjeve ka qenë Besnik Krasniqi (PDK) me 11.27 % të pyetjeve të përgjithshme të drejtuara ndaj punës së organeve të Komunës së Prizren përfshirë edhe punën e zyrtarëve në mandatin e kaluara.

KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

REZULTATET E NOTIMEVE PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS SUHAREKË PËR PERIUDHËN KORRIK - DHJETOR 2008

KUVENDI I KOMUNËS SUHAREKË			Pjesëmarrja në seanca	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Propozim për rend dite	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislacionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm
Nr	Anëtarët e Kuvendit të Komunës	Subjekti politik	%	%	%	%	%	%	%	%
1	Avdyl Sopaj	LDK	80%	1.9%	0%	3.5%	0%	0%	0%	1.3%
2	Bashkim Berisha	LDK	100%	3.1%	0%	0%	0%	0%	11.1%	3.6%
3	Bexhet Kuçi	LDK	100%	3.1%	0%	5.9%	0%	0%	5.6%	3.6%
4	Fetie Kuçi	LDK	100%	1.9%	16.7%	2.4%	0%	0%	5.6%	2.4%
5	Halit Elshani **	LDK	100%	3.7%	0%	1.2%	0%	0%	0%	1.2%
6	Hidajete Haliti	LDK	80%	0.6%	0%	1.2%	0%	0%	0%	0.4%
7	Kimete Bytyçi	LDK	80%	1.9%	0%	1.2%	0%	3.3%	2.8%	2.3%
8	Lira Mala	LDK	100%	0.6%	0%	0%	0%	0%	2.8%	0.8%
9	Malsore Elshani	LDK	60%	0.6%	0%	0%	0%	0%	2.8%	0.8%
10	Nazim Zenelaj	LDK	100%	1.2%	0%	0%	0%	3.3%	8.3%	3.2%
11	Ramadan Haxhiaj	LDK	100%	4.3%	0%	2.4%	0%	3.3%	5.6%	3.9%
12	Remzi Bytyçi	LDK	100%	0.6%	0%	0%	0%	0%	2.8%	0.8%
13	Rexhep Kuçi *	LDK	100%	6.8%	0%	1.2%	0%	0%	0%	2.0%
14	Sami Jupa	LDK	100%	2.5%	0%	2.4%	0%	3.3%	0%	2.0%
15	Shaqir Kryeziu	LDK	100%	1.9%	0%	3.5%	0%	0%	0%	1.3%
16	Shukrie Salihu	LDK	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
17	Tahir Kolgeci ***	LDK	40%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
18	Xhemajli Shala	LDK	100%	5.0%	0%	10.6%	0%	0%	2.8%	4.6%
19	Arif Daka	PDK	20%	1.2%	0%	1.2%	0%	3.3%	0%	1.4%
20	Driton Krasniqi	PDK	60%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
21	Elmaze Kabashi	PDK	60%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
22	Fatmir Guraziu	PDK	60%	0.6%	0%	1.2%	0%	3.3%	0%	1.3%
23	Hazir Hajdari	PDK	60%	7.5%	0%	7.1%	0%	3.3%	8.3%	6.5%
24	Muhamet Veliu	PDK	80%	6.2%	16.7%	7.1%	0%	0%	8.3%	5.4%
25	Rexhep Manxhuka	PDK	80%	2.5%	0%	3.5%	0%	3.3%	0%	2.3%
26	Safet Hoxha**	PDK	60%	12.4%	33.3%	15.3%	0%	43.3%	5.6%	19.2%
27	Sedrije Sadiku	PDK	60%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
28	Shkurte Morina	PDK	60%	0.6%	0%	0%	0%	0%	0%	0.2%
29	Zoja Zenelaj	PDK	60%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
30	Xheladin Buqa	PDK	60%	4.3%	0%	7.1%	0%	3.3%	2.8%	4.4%
31	Bahrije Kokollari	LDD	100%	0.6%	0%	0%	0%	0%	0%	0.2%
32	Leonora Reshita	LDD	100%	0.6%	0%	1.2%	0%	0%	0%	0.4%
33	Muhamet Bajraktari**	LDD	100%	3.1%	0%	1.2%	0%	0%	0%	1.1%
34	Urim Suka	LDD	100%	3.1%	0%	2.4%	0%	0%	8.3%	3.4%
35	Nadire Hoxha	AAK	100%	5.6%	16.7%	3.5%	0%	6.7%	8.3%	6.0%
36	Vesel Maliqaj	AAK	80%	0.6%	0%	1.2%	0%	0%	0%	0.4%
37	Haxhi Sallauka	AKR	60%	0.6%	0%	0%	0%	0%	2.8%	0.8%
38	Sedrije Berisha	AKR	80%	0.6%	0%	0%	0%	0%	0%	0.2%
39	Adem Kadolli	LPK	100%	9.3%	16.7%	12.9%	0%	16.7%	5.6%	11.1%
40	Hanife Rakaqi	LPK	60%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
41	Isuf Krasniqi	PD	100%	0.6%	0%	0%	0%	3.3%	0%	1.0%

Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca			Pjesëmarrja në seanca	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Propozim për rend dite	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislacionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm
Nr	Subjektet politike	Numri i anëtarëve	%	%	%	%	%	%	%	%
1	LDK	18	91.1%	39.8%	16.7%	35.3%	0%	13.3%	50%	31.0%
2	PDK	12	60%	35.4%	50%	42.4%	0%	60%	25.0%	42.6%
3	LDD	4	100%	7.5%	0%	4.7%	0%	0%	8.3%	4.1%
4	AAK	2	90%	6.2%	16.7%	4.7%	0%	6.7%	8.3%	8.5%
5	AKR	2	70%	1.2%	0%	0%	0%	0%	2.8%	0.8%
6	LPK	2	80%	9.3%	16.7%	12.9%	0%	16.7%	5.6%	12.2%
7	PD	1	100%	0.6%	0%	0%	0%	3.3%	0%	0.8%

LEGJENDA

* - Kryetari i Kuvendit të Komunës

** - Shefat e Grupeve Parlamentare

*** - Anëtarët e ri të Kuvendit

Rr - Rregulloret e propozuara

KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

NOTIMI I PËRGGJITHSHËM

Kuvendi i Komunës së Suharekës numëron gjithsej 41 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 7 subjekte politike (LDK, PDK, LDD, AAK, AKR, LPK, PD).

Anëtarët e Kuvendit të Komunës në Suharekë që kanë shënuar rezultate më të kënaqshme në të gjitha kategoritë janë:

Safet Hoxha	PDK	19.2%
Adem Kadolli	LPK	11.1%

Anëtarët që kanë treguar rezultatet më të dobëta (0.5% – 0.1%) në të gjitha kategoritë janë:

Hidajete Haliti	LDK	0.4%
Leonora Reshitaj	LDD	0.4%
Vesel Maliqaj	AAK	0.4%
Shkurte Morina	PDK	0.2%
Bahrije Kokollari	LDD	0.2%
Sevdije Berisha	AKR	0.2%

Anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultatet në të gjitha kategoritë janë:

Shukrie Salihu	LDK	0.0%
Tahir Kolgeci	LDK	0.0%
Driton Krasniqi	PDK	0.0%
Elmaze Kabashi	PDK	0.0%
Sevdije Sadiku	PDK	0.0%
Zoja Zenelaj	PDK	0.0%
Hanife Rakaqi	LPK	0.0%

(Sipas këtyre të dhënave anëtari që ka treguar performancë më të lartë është Safet Hoxha me 19.2 %. Ndërkaq janë 7 anëtarë të Kuvendit të Komunës së Suharekës që asnjëherë nuk kanë diskutuar në foltoren e Kuvendit të Komunës dhe janë vlerësuar me 0%.)

Krahasuar me gjashtëmuorin e parë të vitit 2008, në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës kanë treguar angazhim më të lartë në plasimin dhe artikulimin e interesave qytetare pranë këtij organi dhe si rezultat i saj 50 % është më i ulët numri i anëtarëve të vlerësuar me 0 % në krahasim me gjashtëmuorin e kaluar.

MUNGESAT NË SEANCA

Në gjashtë seancat e mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës kanë treguar motiv të lartë për pjesëmarrje në seanca. Për dallim prej gjashtëmuorit të parë të vitit 2008, asnjë anëtar nuk ka munguar në më shumë se 50 % të seancave.

Tahit Kolgeci është anëtar i ri i Kuvendit të Komunës i zëvendësuar me Vitor Markajt, po ashtu është i rregullt në pjesëmarrje në seanca.


TRENDI I DISKUTIMEVE

Niveli më i lartë i pjesëmarrjes në diskutime të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Suharekës gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 është shënuar në seancat e muajit Gusht dhe Dhjetor me 46 % ku në rend dite mes tjerash ka qenë Rregullorja e Punës e Kuvendit të Komunës së Suharekës dhe shqyrtimi i marrëveshjes mes Komunës dhe kompanisë Ben-Af, ndërsa niveli më i ulët i pjesëmarrjes në diskutim është shënuar në seancën e Korrikut me 20 %.


Vlen të përmendet niveli i lartë i pjesëmarrjes në diskutime të anëtarët nga radhët e LDK-së me 39.8 % edhe pse parti në Pozitë, për të vazhduar me anëtarët nga radhët e PDK-së me 35.4 % në Kuvendin e Komunës së Suharekës.

Safet Hoxha (PDK) dhe Adem Kadolli (LPK) janë anëtarët që kanë treguar angazhim më të lartë në shqyrtimin e pikave të rendit të ditës në gjashtë seancat e mbajtura gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 me 12.4% përkatësisht 9.3%.

Trendi i diskutimeve korrik-dhjetor 2008



Niveli i diskutimeve sipas subjektit politik



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

PROPOZIME PËR REND DITE

Në gjashtë seancat e mbajtura në Kuvendin e Komunës së Suharekës gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 janë propozuar gjashtë pika për rend dite dy prej të cilave nga Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së Safet Hoxha, dhe nga një propozim për pikë të rendit të ditës nga Fetie Kuçi (LDK), Muhamet Veliu (PDK), Nadire Hoxha (AAK) dhe Adem Kadolli (LPK).

KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË


INICIMI I ÇËSHTJEVE

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës gjatë gjashtë seancave të mbajtura për periudhën Korrik – Dhjetor 2008 kanë ngritur çështje të ndryshme të cilat në një mënyrë prekin interesat e qytetarëve. Por marrë në përgjithësi, pjesa më e madhe e çështjeve të ngritura janë të natyrës procedurale gjithsej 52 % përcjellur nga ato të infrastrukturës dhe ekonomisë me 27% përkatësisht 13 %.


Sa i përket subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Suharekës, anëtarët nga radhët e PDK-së prijnë për nga numri i çështjeve të iniciuara me gjithsej 42.4 % të pasuar nga anëtarët e LDK-së me 35.3 %.

Ndërkaq 17 anëtarë të Kuvendit të Komunës së Suharekës gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor nuk kanë ngritur asnjë çështje që krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2008 kemi një rritje prej 6 % të numrit të anëtarëve që nuk kanë treguar angazhim të duhur në ngritjen e çështjeve me interes për qytetarët.

Anëtarët më aktiv gjatë kësaj periudhe në ngritjen e çështjeve dhe shqyrtimin e tyre në Kuvendin e Komunës së Suharekës janë: Safet Hoxha (PDK) me 15.3%, Adem Kadolli (LPK) me 12.9% dhe Xhemajli Shala (LDK) me 10.6%.



Çështjet e iniciuara



Seancat e muajit Shtator dhe Dhjetor janë seancat gjatë të cilave janë ngritur numri më i madh i çështjeve. Në rend dite të këtyre seancave mes tjerash kanë qenë edhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2009/2011 dhe Rregullorja e Punës e Kuvendit të Komunës së Suharekës.

RREGULLORET E INICUARA


Gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 Kuvendi i Komunës së Suharekës ka miratuar Rregulloren për tarifatat, ngarkesat dhe gjokat nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale, Rregulloren e tatimit në pronë, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Suharekës dhe Rregulloren mbi përdorimin e gjuhëve në Komunën e Suharekës

PROPOZIMI I AMANDAMENTEVE

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 kanë propozuar gjithsej 30 amendamente me ç'rast 60 % e të cilave janë propozuar nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

Anëtari më aktiv në Kuvendin e Komunës së Suharekës në propozim të amendamenteve gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 ka qenë Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së Safet Hoxha me 43.3 % dhe Adem Kadolli (LPK) me 16.6 %.

Propozimi i amendamenteve sipas subjekteve



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK


KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

PYETJET E ANËTARËVE

Në gjashtë seancat e mbajtura gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 në Kuvendin e Komunës së Suharekës janë regjistruar 36 pyetje të anëtarëve si instrument për të ndihmuar ndërtimin e raportit për llogaridhënie të degës së ekzekutivit përballë legjislativit komunal.

Anëtarët nga radhët e LDK-së janë treguar më të zëshmit në parashtrimin e pyetjeve me gjithsej 50 % të pasuar nga anëtarët e PDK-së me 25 %.


Llojet e pyetjeve



Numri më i madh i këtyre pyetjeve është realizuar në seancën e muajit Gusht me gjithsej 47 % të pyetjeve të përgjithshme. Në rend dite të kësaj seance mes tjerash ka qenë edhe shqyrtimi i marrëveshjes mes Komunës dhe kompanisë Ben-Af.

Pjesa më e madhe e pyetjeve të realizuara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 kanë qenë pyetje të karakterit procedural me 53 %.

Pyetjet sipas subjekteve



Nga 41 anëtarë të Kuvendit Komunal të Suharekës, gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008, 23 prej tyre ose shprehur në përqindje 56 % e tyre nuk kanë parashtruar asnjë pyetje, vetëm 44 % e anëtarëve kanë parashtruar pyetje nga fusha të ndryshme të punës së organeve të Komunës së Suharekës.

Ndërkaq anëtari më aktiv në paraqitjen e pyetjeve gjatë kësaj periudhe ka qenë Bashkim Berisha (LDK) me 11 % të pyetjeve të përgjithshme.

REZULTATET E NOTIMEVE PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS MALISHEVË PËR PERIUHDHËN KORRIK - DHJETOR 2008

KUVENDI I KOMUNËS MALISHEVË			Pjesëmarrja në seanca	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Propozim për rend dite	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislacionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm
Nr	Anëtarët e Kuvendit të Komunës	Subjekti politik	%	%	%	%	%	%	%	%
1	Fadil Shala ***	PDK	100%	0.5%	0%	0%	0%	6.7%	0%	1.8%
2	Mursel Gashi *	PDK	100%	12.3%	25.0%	7.9%	0%	0%	0.7%	5.2%
3	Hasime Krasniqi **	PDK	75.0%	8.6%	0%	4.4%	Rr	4.4%	6.9%	6.1%
4	Naim H Morina	PDK	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
5	Naim Kryeziu	PDK	100%	0.5%	0%	0.9%	0%	0%	0%	0.3%
6	Naim Morina	PDK	100%	0.5%	0%	0.9%	0%	0%	1.4%	0.7%
7	Merita Krasniqi	PDK	75.0%	0.5%	0%	0.9%	0%	0%	0.7%	0.5%
8	Afrim Zogaj	PDK	100%	0.5%	0%	0.9%	0%	0%	0%	0.3%
9	Haki Kryeziu	PDK	100%	3.2%	0%	0.9%	0%	2.2%	0.7%	1.7%
10	Rajmonda Krasniqi	PDK	100%	0.9%	0%	0.9%	0%	0%	1.4%	0.8%
11	Besim Dobruna	PDK	100%	0.5%	0%	0%	0%	0%	0%	0.1%
12	Lumni Kryeziu	PDK	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
13	Sinan Gegaj	PDK	100%	4.5%	0%	7.9%	0%	6.7%	2.8%	5.5%
14	Shukrie Bytyqi	PDK	75.0%	0.9%	0%	0.9%	0%	0%	0%	0.4%
15	Qamil Hoti	PDK	75.0%	3.6%	0%	0.9%	0%	8.9%	11.0%	6.1%
16	Zemrie Lima	PDK	75.0%	0.5%	0%	0%	0%	11.1%	0%	2.9%
17	Januz Kastrati**	LDK	100%	19.1%	50%	30.7%	0%	8.9%	34.5%	23.3%
18	Fetah Rudi	LDK	100%	4.1%	25.0%	5.3%	0%	0%	4.1%	3.4%
19	Milazim Kryeziu	LDK	100%	1.8%	0%	0.9%	0%	0%	1.4%	1.0%
20	Ramadan Buzhala	LDK	75.0%	0.5%	0%	0.9%	0%	0%	0.7%	0.5%
21	Zahide Kastrati	LDK	100%	0.5%	0%	0%	0%	0%	0.7%	0.3%
22	Sadri Robaj	LDK	100%	9.5%	0%	6.1%	0%	0%	6.9%	5.6%
23	Adem Krasniqi	LDK	100%	3.6%	0%	5.3%	0%	2.2%	2.8%	3.5%
24	Bukurie Mazreku	LDK	100%	0.9%	0%	0.9%	0%	0%	0.7%	0.6%
25	Hamdi Mazreku	LDK	100%	6.4%	0%	6.1%	0%	48.9%	8.3%	17.4%
26	Remzie Thaqi	LDK	100%	2.3%	0%	0.9%	0%	0%	2.8%	1.5%
27	Sadbere Hoxha	LDK	75.0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
28	Alban Kastrati	AKR	100%	3.6%	0%	2.6%	0%	0%	2.1%	2.1%
29	Milazim Rudi	LDD	75.0%	4.5%	0%	7.9%	0%	0%	3.4%	4.0%
30	Avni Robaj	AAK	75.0%	4.5%	0%	5.3%	0%	0%	2.8%	3.1%
31	Sefer Avdiaj	ORA	75.0%	1.4%	0%	0%	0%	0%	3.4%	1.2%
Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca										
Nr	Subjektet politike	Numri i anëtarëve	Pjesëmarrja në seanca	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Propozim për rend dite	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamen- timi i legjila- cionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm
1	PDK	16	92.2%	37.3%	25.0%	27.2%	Rr	40%	25.5%	31.0%
2	LDK	11	95.5%	48.6%	75.0%	57.0%	0%	60%	62.8%	60.7%
3	AKR	1	100%	3.6%	0%	2.6%	0%	0%	2.1%	1.7%
4	LDD	1	75.0%	4.5%	0%	7.9%	0%	0%	3.4%	3.2%
5	AAK	1	75.0%	4.5%	0%	5.3%	0%	0%	2.8%	2.5%
6	ORA	1	75.0%	1.4%	0%	0%	0%	0%	3.4%	1.0%
LEGJENDA										
* - Kryetari i Kuvendit të Komunës										
** - Shefat e Grupeve Parlamentare										
*** - Anëtarët e ri të Kuvendit										
Rr - Rregulloret e propozuara										

KUVENDI I KOMUNËS - MALISHEVË

NOTIMI I PËRGJITHSHËM

Kuvendi i Komunës në Malishevë numëron gjithsej 31 anëtarë të kuvendit, të cilët përfaqësojnë 6 subjekte politike (PDK, LDK, AKR, LDD, AAK, ORA).

Anëtarët e Kuvendit të Komunës që kanë shënuar rezultate më të kënaqshme në të gjitha kategoritë janë:

Januz Kastrati LDK 23.3%
Hamdi Mazreku LDK 17.4%

Anëtarët që kanë treguar rezultatet më të dobëta (0.5% – 0.1%) në të gjitha kategoritë janë:

Merita Krasniqi PDK 0.5%
Ramadan Buzhala LDK 0.5%
Shukrie Bytyçi PDK 0.4%
Naim Kryeziu PDK 0.3%
Afrim Zogaj PDK 0.3%
Zahide Kastrati LDK 0.3%
Besim Dobruna PDK 0.1%

Anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultatet në të gjitha kategoritë janë:

Naim H Morina PDK 0.0%
Lumni Kryeziu PDK 0.0%
Sadbere Hoxha LDK 0.0%

(Sipas këtyre të dhënave anëtari që ka treguar performancë më të lartë është Januz Kastrati me 23.3 %. Ndërkaq janë 3 anëtarë të Kuvendit të Komunës së Malishevës që asnjëherë nuk kanë diskutuar në foltoren e Kuvendit të Komunës dhe janë vlerësuar me 0%.)

Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2008, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008 anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës kanë treguar angazhim më të shtuar në drejtim të përfaqësimit të interesit të qytetarëve në këtë institucion duke avancuar edhe më tej punën e Kuvendit të Komunës së Malishevës.

MUNGESAT NË SEANCA

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës kanë treguar vullnet të lartë për pjesëmarrje në katër seancat e mbajtura gjatë periudhës Korrik- Dhjetor 2008 dhe nuk është evidentuar asnjë anëtar i kuvendit të ketë munguar më shumë se 50% të seancave të mbajtura në këtë periudhë.

TRENDI I DISKUTIMEVE

Pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës në diskutim lidhur me shqyrtimin e pikave të parapara për e rend të ditës është në nivel mesatar.

Niveli i pjesëmarrjes në diskutime gjatë seancave të mbajtura për periudhën Korrik-Dhjetor 2008 lëviz nga kuota më e ulët e shënuar në muajin Dhjetor prej 32% deri në kuotën më të lartë 67% të shënuar në dy takimet e mbledhjes së mbajtur në muajit Shtator.

Pjesa më e madhe e këtyre diskutimeve përkatësisht 49% e tyre janë të drejtuara për çështje procedurale siç janë miratimi i Statutit të Komunës së Malishevës, raporti 6 mujor i Qeverisë Komunale (Raportet e drejtorive) dhe çështje të tjera të cilat jo direkt ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.


Në katër seancat e mbajtura gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës nga radhët e LDK-së kanë shënuar pjesëmarrje më të lartë në diskutime mbi pika të rendit të ditës me 48.6 %, të përcjellë nga anëtarët nga radhët e PDK-së me 37.3 %. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2008, gjatë kësaj periudhe vërehet shkrirje e lehtë e diferencës në mes pozitës dhe opozitës në aspektin e përfshirjes së anëtarëve të tyre në diskutime për çështje të ndryshme.

Gjatë seancave të mbajtura për periudhën Korrik-Dhjetor 2008, subjekti politik që ka treguar rezultate më të larta është LDK i cili përfaqësohet nga anëtari Januz Kastrati, megjithatë në krahasim me gjashtëmujorin e parë vërehet pjesëmarrje aktive dhe shpërndarje e përgjegjësive edhe tek anëtarët tjerë nga radhët e këtij subjekti politik të përfaqësuar në këtë Kuvend.


PROPOZIME PËR REND DITE

Në katër seancat e mbajtura në Kuvendin e Komunës së Malishevës gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 janë propozuar katër pika për rend dite dy prej të cilave nga Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së Januz Kastrati, dhe nga një propozim për pikë të rendit të ditës nga Fetah Rudi (LDK) dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës Mursel Gashi (PDK).

Trendi i diskutimeve korrik-dhjetor 2008



Niveli i diskutimeve sipas subjektit politik



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

KUVENDI I KOMUNËS - MALISHEVË


INICIMI I ÇËSHTJEVE

Gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor, nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës janë ngritur dhe trajtuar gjithsej 114 çështje të natyrave të ndryshme prej të cilave 51 % e çështjeve të ngritura lidhen drejtpërdrejtë me brengat e qytetarëve ndërsa 49 % e çështjeve të ngritura janë çështje me karakter procedural.

Çështjet të cilat janë ngritur për diskutim nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Malishevë janë çështje të natyrave të ndryshme kryesisht çështje të karakterit procedural, çështje me interes ose brenga të qytetarëve me karakter infrastrukturor, ekonomi, ambient, shëndetësi, arsim dhe çështje të tjera.


Në Kuvendin e Komunës së Malishevës anëtarët e LDK-së prijnë për nga iniciimi i çështjeve me 57% të çështjeve të ngritura e përcjellë nga anëtarët e PDK-së me 27% të çështjeve të iniciuara.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës të Malishevës nga radhët e AKR-së, LDD-së, AAK-së dhe ORA-s bashkërisht kanë ngritur 15.7 % të çështjeve të përgjithshme.



Çështjet e iniciuara

Inicimi i çështjeve sipas subjektit politik



Shkrirje e diferencës në mes subjekteve të pozitës dhe opozitës në Kuvendin e Komunës së Malishevës është realizuar edhe në aspektin e ngritjes së çështjeve.

Nga 31 anëtarë të Kuvendit të Komunës së Malishevës, më aktiv në iniciim të çështjeve është treguar shefi i grupit parlamentar Januz Kastrati (LDK) me 30.7 % të çështjeve të përgjithshme.

Ndërkaq 8 anëtarë të Kuvendit të Komunës së Malishevës nuk kanë iniciuar çështje nga fushat me interes për qytetarët e Malishevës.

Seanca e datës 12 Shtator 2008, ku pos tjerash në rend dite ka qenë edhe shqyrtimi dhe miratimi në parim i Statutit të Komunës së Malishevës dhe Raporti për punën gjashtëmuajore të Qeverisë së Komunës së Malishevës, ka qenë seanca me numrin më të madh të çështjeve të ngritura me gjithsej 53 çështje.

RREGULLORET E INICUARA

Gjatë katër seancave të mbajtura në Kuvendin e Komunës së Malishevës gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008, është miratuar Rregullorja për tatimin në pronë për vitin 2009 dhe Rregullorja e Punës e Kuvendit të Komunës së Malishevës.


Hasime Krasniqi (PDK) ka iniciuar themelimin e Rregullores për Mbrojtje të Ambientit dhe është e vetmja anëtare nga 165 anëtarët e pesë kuvendeve komunale të Regjionit të Prizrenit që ka iniciuar hartim të rregullores.

PROPOZIMI I AMANDAMENTEVE

Gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 në Kuvendin e Komunës së Malishevës janë propozuar gjithsej 45 amendamente. Nga këto, LDK ka bërë 60 % të amendamenteve, ndërkohë që PDK ka bërë 40 % të amendamenteve.

Numri më i madh i amendamenteve nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës është bërë gjatë seancës së datës 12 Shtator 2008 ku në rend dite mes tjerash ka qenë edhe shqyrtimi dhe miratimi në parim i Statutit të Komunës së Malishevës.

Propozimi i amendamenteve sipas subjekteve




Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

Hamdi Mazreku (LDK) është anëtari që kanë propozuar numrin më të lartë të amendamenteve gjatë katër seancave të mbajtura në këtë periudhë me 49 % të amendamenteve


KUVENDI I KOMUNËS - MALISHEVË

PYETJET E ANËTARËVE

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 kanë parashtruar gjithsej 145 pyetje ndaj ekzekutivit të kësaj komune prej të cilave 50 % e këtyre pyetjeve kanë qenë pyetje procedurale të punës së organeve të Komunës së Malishevës.



Anëtarët e LDK-së në Malishevë prijnë me numrin e pyetjeve të bëra gjatë kësaj periudhe me gjithsej 62.7% të pyetjeve të pasuar nga anëtarët e PDK-së me 25.5% të pyetjeve të përgjithshme. Pyetjet e anëtarëve nga radhët e AKR-së, LDD-së, AAK-së dhe ORA-s ndërkaq përbëjnë rreth 11.5% të pyetjeve të përgjithshme të parashtruara gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008.



Seanca e datës 12 Shtator 2008, ku në rend dite mes tjerash kanë qenë edhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2009 dhe Raporti për punën gjashtëmuajore të Qeverisë së Komunës së Malishevës, ka qenë seancë gjatë së cilës janë bërë numri më i madh i pyetjeve, gjithsej 80% të pyetjeve të përgjithshme.

Nga 31 anëtarë sa numëron Kuvendi i Komunës së Malishevës, gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 gjithsej 9 anëtarë nuk kanë bërë asnjë pyetje.

Anëtarët që kanë bërë më së shumti pyetje gjatë kësaj periudhe janë Januz Kastrati (LDK) me 34.5% dhe Qamil Hoti (PDK) me 11% të pyetjeve të përgjithshme.

REZULTATET E NOTIMEVE PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS RAHOVEC PËR PERIUHDHËN KORRIK - DHJETOR 2008

KUVENDI I KOMUNËS RAHOVEC			Pjesëmarrja në seanca	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seanceve	Propozim për rend dite	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjisacionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm
Nr	Anëtarët e Kuvendit të Komunës	Subjekti politik	%	%	%	%	%	%	%	%
1	Baton Cena	PDK	100%	0.6%	0%	0.5%	0%	0%	0%	0.3%
2	Beatrisa Demiri	PDK	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
3	Haxhi Dellova	PDK	100%	0.6%	0%	0%	0%	0%	0%	0.2%
4	Diellza Hoxha	PDK	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
5	Drita Vuçitërna	PDK	100%	0.3%	0%	0%	0%	0%	0%	0.1%
6	Vebi Muharremi	PDK	100%	0.6%	0%	0.5%	0%	0%	1.5%	0.6%
7	Jahja Shehu	PDK	83.3%	0.6%	0%	0%	0%	0%	1.5%	0.5%
8	Lumturije Ukimeraj	PDK	100%	1.2%	0%	1.4%	0%	0%	0%	0.7%
9	Xhemajli Haxhimustafa*	PDK	100%	12.5%	0%	6.5%	0%	0%	0%	4.7%
10	Xhevdet Duraku	PDK	100%	1.6%	0%	1.4%	0%	0%	0%	0.7%
11	Fatmir Kadiri***	PDK	100%	0.3%	0%	0%	0%	0%	0%	0.1%
12	Avdullah Kryeziu	LDK	100%	9.7%	0%	8.3%	0%	18.5%	25.0%	15.4%
13	Bedredin Shehu	LDK	100%	9.7%	0%	12.0%	0%	0%	7.4%	7.2%
14	Ganimete Dellova	LDK	100%	0.9%	0%	0.5%	0%	0%	4.4%	1.5%
15	Ibrahim Hoti	LDK	100%	2.5%	0%	1.8%	0%	0%	0%	1.1%
16	Kujtim Popaj	LDK	100%	3.4%	25.0%	5.1%	0%	7.4%	1.5%	4.3%
17	Nahit Elshani**	LDK	100%	8.1%	25.0%	15.7%	0%	29.6%	13.2%	16.7%
18	Nazife Hundazi	LDK	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
19	Shahzije Vuçitërna	LDK	100%	0.9%	0%	0.9%	0%	0%	0%	0.5%
20	Agim Thaçi	AAK	83.3%	2.2%	0%	3.2%	0%	3.7%	0%	2.3%
21	Enver Sylka**	AAK	100%	8.1%	0%	8.3%	0%	25.9%	10.3%	13.2%
22	Feim Fetoshi	AAK	100%	8.4%	50%	10.6%	0%	0%	8.8%	7.0%
23	Hysnije Sylka	AAK	100%	2.2%	0%	1.8%	0%	0%	1.5%	1.4%
24	Rukije Krasniqi	AAK	100%	4.0%	0%	3.7%	0%	3.7%	7.4%	4.7%
25	Bajram Morina	AKR	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
26	Zana Sharku	AKR	100%	0.3%	0%	0%	0%	0%	0%	0.1%
27	Hamëz Alirifa	LDD	100%	3.4%	0%	2.8%	0%	0%	2.9%	2.3%
28	Sahadete Dula	LDD	100%	2.2%	0%	1.4%	0%	0%	4.4%	2.0%
29	Florije Boshnjaku	LKÇK	100%	6.5%	0%	5.1%	0%	0%	7.4%	4.7%
30	Salih Hoti	LKÇK	100%	9.0%	0%	8.8%	0%	11.1%	2.9%	8.0%
31	Hamdi Dërmala	PD	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca			Pjesëmarrja në seanca	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seanceve	Propozim për rend dite	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjisacionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm
Nr	Subjektet politike	Numri i anëtarëve	%	%	%	%	%	%	%	%
1	PDK	11	98.3%	18.4%	0%	10.1%	0%	0%	2.9%	6.3%
2	LDK	8	100%	35.2%	50%	44.2%	0%	55.6%	51.5%	47.3%
3	AAK	5	96.7%	24.9%	50%	27.6%	0%	33.3%	27.9%	32.8%
4	AKR	2	100%	0.3%	0%	0%	0%	0%	0%	0.1%
5	LDD	2	100%	5.6%	0%	4.1%	0%	0%	7.4%	3.4%
6	LKÇK	2	100%	15.6%	0%	13.8%	0%	11.1%	10.3%	10.2%
7	PD	1	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%

LEGJENDA

* - Kryetari i Kuvendit të Komunës
 ** - Shefat e Grupeve Parlamentare
 *** - Anëtarët e ri të Kuvendit

Rr - Rregulloret e propozuara

KUVENDI I KOMUNËS - RAHOVEC

NOTIMI I PËRGJITHSHËM

Kuvendi i Komunës në Rahovecit numëron gjithsej 31 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 7 subjekte politike (PDK, LDK, AAK, LKÇK, AKR, LDD dhe PD).

Anëtarët e Kuvendit të Komunës që kanë shënuar rezultate më të kënaqshme në të gjitha kategoritë janë:

Nahit Elshani	LDK	16.7%
Avdullah Kryeziu	LDK	15.4%
Enver Sylka	AAK	13.2%

Anëtarët që kanë treguar rezultatet më të dobëta (0.5% – 0.1%) në të gjitha kategoritë janë:

Jahja Shehu	PDK	0.5%
Shahzije Vuçitërna	LDK	0.5%
Baton Cena	PDK	0.3%
Haxhi Dellova	PDK	0.2%
Drita Vuçitërna	PDK	0.1%
Fatmir Kadiri	PDK	0.1%
Zana Sharku	AKR	0.1%

Anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultatet në të gjitha kategoritë janë:

Beatrisa Demiri	PDK	0.0%
Diellza Hoxha	PDK	0.0%
Nazife Hundozi	LDK	0.0%
Bajram Morina	AKR	0.0%
Hamdi Dërmala	PD	0.0%

(Sipas këtyre të dhënave anëtarët me performancë më të lartë janë Nahit Elshani (LDK) me 16.7 %, Avdullah Kryeziu (LDK) me 15.4 % dhe Enver Sylka (AAK) me 13.2 %. Ndërkaq të vlerësuar me 0 % janë 5 anëtarë.)

Në gjashtë seancat e mbajtura gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 në Kuvendin e Komunës së Rahovecit anëtarët e këtij kuvendi nuk kanë treguar ndonjë ndryshim të theksuar në angazhimin e tyre në drejtim të përfaqësimit të interesave të qytetarëve krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2008.

MUNGESAT NË SEANCA

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit kanë treguar nivel të lartë të pjesëmarrjes në gjashtë seancat e mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe nuk është shënuar asnjë anëtar të ketë munguar në më shumë se 50% të seancave të mbajtura në këtë periudhë.

TRENDI I DISKUTIMEVE

Pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit në lidhje me pikat e rendit të ditës është në nivel mesatar dhe zakonisht përcillet nga një trend i përafërta i përfshirjes në diskutime të anëtarëve.

Duhet theksuar se gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 Kuvendi i Komunës së Rahovecit pos procedimit me çështje procedurale siç janë aprovimi i Statutit të Komunës, zgjedhja e Kryesuesit dhe çështje të ngjashme procedurale ka shqyrtuar edhe një sërë kërkesash të paraqitura nga qytetarët e Komunës së Rahovecit por në mungesë të infrastrukturës teknike dhe mungesës së përgatitjes profesionale të materialeve të nevojshme shpesh këto çështje nuk kanë arritur të gjejnë përfundimin e dëshiruar.


Seanca në të cilën gjatë kësaj periudhe është shënuar pjesëmarrja më e lartë në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit ka qenë ajo e datës 29 Shtator me ç’rast 58 % e anëtarëve kanë qenë të përfshirë në diskutime për pikat e rendit të ditës ku mes tjerash në rend dite ka qenë edhe raportit nëntëmujor i shpenzimeve të Komunës së Rahovecit për periudhën Janar – Nëntor 2008, raporti për përfundimin e vitit shkollor 2007/2008 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2008/2009.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit nga radhët e LDK-së kanë shënuar nivelin më të lartë të pjesëmarrjes në diskutime gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 me 35.2 % të pasuar nga anëtarët e AAK-së me 24.9 %.


Ndërkaq anëtarët e AKR-së, LDD-së dhe PD-së bashkërisht përbëjnë vetëm 5.9 të diskutimeve të përgjithshme.

Pjesëmarrjen më të lartë në diskutime gjatë kësaj periudhe e kanë shënuar Avdullah Kryeziu (LDK) dhe Bedredin Shehu (LDK) me nga 9.7 % të diskutimeve të përgjithshme.

Trendi i diskutimeve korrik-dhjetor 2008



Niveli i diskutimeve sipas subjektit politik



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

KUVENDI I KOMUNËS - RAHOVEC

PROPOZIME PËR REND DITE

Në gjashtë seancat e mbajtura në Kuvendin e Komunës së Rahovecit gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 janë propozuar katër pika për rend dite dy prej të cilave nga Feim Fetoshi (AAK) dhe nga një propozim për rend dite kanë dhënë Kujtim Popaj (LDK) dhe Nahit Elshani (LDK).

INICIMI I ÇËSHTJEVE


Në gjashtë seancat e mbajtura gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit janë iniciuar gjithsej 217 çështje prej të cilave 44% e çështjeve janë procedurale që kanë të bëjnë me funksionimin e organeve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Në Kuvendin e Komunës së Rahovecit anëtarët e LDK-së prijnë për nga iniciimi i çështjeve me gjithsej 44.2 % të çështjeve të iniciuara të pasuar nga anëtarët e AAK-së me 27.6 % dhe ata të LKÇK-së me 13.8 % të çështjeve të iniciuara. Anëtarët e LDD-së kanë iniciuar vetëm 4.1 % të çështjeve të përgjithshme gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 në Kuvendin e Komunës së Rahovecit.

Anëtari më aktiv në iniciimin e çështjeve gjatë seancave të mbajtura në këtë periudhë është Nahit Elshani, Shef i Grupit Parlamentar të LDK-së me 15.7 % të numrit të përgjithshëm të çështjeve të iniciuara.


Nga 31 anëtarë sa numëron Kuvendi i Komunës së Rahovecit gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 gjithsej 10 anëtarë asnjëherë nuk kanë ngritur ndonjë çështje me interes për qytetarët.

Seanca në të cilën është vërejtur numër më i lartë i iniciimit të çështjeve ka qenë ajo e muajit Dhjetor me 30 % të çështjeve të iniciuara. Në këtë seancë në rend dite mes tjerash kanë qenë edhe raportit të punës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për gjendjen financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës si dhe shqyrtimi i kërkesës së Kryesisë së fshatit Brestoc për ndërprerjen e punimeve në Zyrën e Vendit në Hoçë të Vogël.



Çështjet e iniciuara

Inicimi i çështjeve sipas subjektit politik




RREGULLORET E INICUARA

Në gjashtë seancat e mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 në Kuvendin e Komunës së Rahovecit me inicim të Qeverisë Komunale është miratuar Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba si edhe Rregullorja për caktimin e tatimit në pronë

PROPOZIMI I AMANDAMENTEVE

Në gjashtë seancat e mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 në Kuvendin e Komunës së Rahovecit janë propozuar gjithsej 27 amendamente. Nga këto, LDK ka bërë 55.6 % të propozimeve për amendamentim të përcjellë nga anëtarët e AAK-së me 33.3 % dhe LKÇK-së me 11.1 % të propozimeve për amendamentim.

Propozimi i amendamenteve sipas subjekteve




Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

Anëtarë më aktiv në propozim të amendamenteve është Nahit Elshani (LDK) me 29.6 % i përcjellë nga Enver Sylka (AAK) me 25.9 % të propozimeve për amendamentim.


KUVENDI I KOMUNËS - RAHOVEC

PYETJET E ANËTARËVE

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008 kanë bërë gjithsej 68 pyetje ndaj ekzekutivit të kësaj komune, prej të cilave 41 % e këtyre pyetjeve janë të lidhura me aspekte procedurale të punës së organeve të Komunës së Rahovec.



Anëtarët e LDK-së në Kuvendin e Komunës së Rahovecit prijnë me numrin e pyetjeve të bëra gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 me gjithsej 51.5 % të pyetjeve të bëra, të pasuar nga anëtarët e AAK-së të cilët kanë bërë 27.9 % të pyetjeve të përgjithshme.



Anëtarët që kanë bërë më së shumti pyetje gjatë gjashtë seancave të mbajtura në këtë periudhë Avdullah Kryeziu (LDK) me 25.0 % dhe Nahit Elshani (LDK) me 13.2 % të pyetjeve të përgjithshme.

Nga 31 anëtarë të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, gjatë gjashtë seancave të mbajtura në periudhën Korrik – Dhjetor 2008 gjithsej 16 anëtarë nuk kanë bërë asnjë pyetje.

Seancat e datës 2 Korrik dhe 29 Shtator janë seanca gjatë të cilave anëtarët e Kuvendit Komunal të Rahovecit kanë bërë më së shumti pyetje me nga 39 përkatësisht 38 % të pyetjeve të përgjithshme gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2008.

REZULTATET E NOTIMEVE PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS DRAGASH PËR PERIUHDHËN KORRIK - DHJETOR 2008

KUVENDI I KOMUNËS DRAGASH			Pjesëmarrja në seanca	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seanceve	Propozim për rend dite	Incimi i çështjeve	Incimi i rregulloreve	Amandamenti i legjislacionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përfundimtar
Nr	Anëtarët e Kuvendit të Komunës	Subjekti politik	%	%	%	%	%	%	%	%
1	Adelina Qafleshi	PDK	85.7%	0.5%	0%	0%	0%	0%	0%	0.1%
2	Arbnore Kurtishi	PDK	85.7%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
3	Ibrahim Gashi	PDK	100%	3.2%	0%	0%	0%	0%	0%	0.8%
4	Indire Gashi	PDK	85.7%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
5	Lulzim Rifaj*	PDK	100%	12.8%	0%	9.3%	0%	0%	1.9%	6.0%
6	Mitat Fejza**	PDK	100%	6.8%	0%	5.6%	0%	19.2%	0%	7.9%
7	Shaban Shabani	PDK	100%	2.7%	0%	2.8%	0%	0%	0%	1.4%
8	Ilirjana Sallahu	LDK	100%	0.9%	0%	0%	0%	3.8%	3.7%	2.1%
9	Majlinda Pirkuqi	LDK	85.7%	1.8%	0%	1.9%	0%	0%	11.1%	3.7%
10	Naim Ramadani**	LDK	85.7%	8.7%	20%	14.8%	0%	38.5%	3.7%	16.4%
11	Ymer Ademi	LDK	100%	10.5%	20%	13.9%	0%	11.5%	9.3%	11.3%
12	Xhemal Iljazi	LDK	100%	8.2%	10%	6.5%	0%	3.8%	9.3%	7.0%
13	Irfan Ibrahim	VAKAT	100%	0.5%	0%	0.9%	0%	0%	0%	0.3%
14	Sabidin Çufta	VAKAT	100%	10%	10%	6.5%	0%	7.7%	5.6%	7.4%
15	Zinaida Elmazi	VAKAT	85.7%	4.1%	0%	0.9%	0%	3.8%	5.6%	3.6%
16	Ahmet Beširi	GIG	100%	0.5%	0%	0%	0%	0%	1.9%	0.6%
17	Haćima Nešković	GIG	100%	3.7%	0%	5.6%	0%	0%	5.6%	3.7%
18	Mahmut Mahmuti	AAK	85.7%	7.8%	30%	10.2%	0%	3.8%	18.5%	10.1%
19	Mujdin Jusufi	AKR	100%	3.7%	0%	4.6%	0%	0%	3.7%	3.0%
20	Qamil Kolloni	LDD	85.7%	10.5%	10%	13.0%	0%	7.7%	16.7%	12.0%
21	Nihat Osmani	SDA	100%	3.2%	0%	3.7%	0%	0%	3.7%	2.7%
Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca			Pjesëmarrja në seanca	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seanceve	Propozim për rend dite	Incimi i çështjeve	Incimi i rregulloreve	Amandamen- timi i legjislacionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përfundimtar
Nr	Subjektet politike	Numri i anëtarëve	%	%	%	%	%	%	%	%
1	PDK	7	93.9%	26.0%	0%	17.6%	0%	19.2%	1.9%	12.9%
2	LDK	5	94.3%	30.1%	50%	37.0%	0%	57.7%	37.0%	42.4%
3	VAKAT	3	95.2%	14.6%	10%	8.3%	0%	11.5%	11.1%	11.1%
4	GIG	2	100%	4.1%	0%	5.6%	0%	0%	7.4%	3.4%
5	AAK	1	85.7%	7.8%	30%	10.2%	0%	3.8%	18.5%	14.1%
6	AKR	1	100%	3.7%	0%	4.6%	0%	0%	3.7%	2.4%
7	LDD	1	85.7%	10.5%	10%	13.0%	0%	7.7%	16.7%	11.6%
8	SDA	1	100%	3.2%	0%	3.7%	0%	0%	3.7%	2.1%

LEGJENDA
* - Kryetari i Kuvendit të Komunës
** - Shefat e Grupeve Parlamentare
*** - Anëtarët e ri të Kuvendit

Rr - Rregulloret e propozuara

KUVENDI I KOMUNËS -DRAGASH

NOTIMI I PËRGJITHSHËM

Kuvendi i Komunës në Dragash numëron gjithsej 21 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 8 subjekte politike (PDK, LDK, VAKAT, GIG, AAK, AKR, LDD, SDA).

Anëtarët e Kuvendit të Komunës që kanë shënuar rezultate më të kënaqshme në të gjitha kategoritë janë:

Naim Ramadani	LDK	16.4%
Qamil Kolloni	LDD	12.0%
Ymer Ademi	LDK	11.3%
Mahmut Mahmuti	AAK	10.1%

Anëtarët që kanë treguar rezultatet më të dobëta (0.5% – 0.1%) në të gjitha kategoritë janë:

Irfan Ibrahim	VAKAT	0.3%
Adelina Qaflehi	PDK	0.1%

